



Në pajtim me autoritetin që i është dhënë përmes Ligjit Nr. 03/L-090 për Partneritetet Publiko-Private dhe koncesionet në infrastrukturë si dhe procedurat për dhënien e tyre, Neni 12, Paragrafi 2.3, Komisioni Drejtues Ndërmënytor për Partneritetet Publiko-Private (KDNM- PPP) miraton këtë

## **DIREKTIVË NR. 3 / 2011**

### **Për Shqyrtimin dhe miratimin e projekteve komunale PPP**

## Neni 1: Fushëveprimi

Kjo Direktivë zbatohet për projektet e partneriteteve publiko private të zhvilluara nga komunat në kuadër të fushës së tyre të përgjegjësisë, siç është përcaktuar me ligj.

## Neni 2: Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë Direktivë do ta kenë kuptimin siç janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-090 për Partneritetet Publiko Private dhe koncesionet në infrastrukturë si dhe procedurat për dhënien e tyre, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Direktivë apo nëse konteksti, në të cilin termi është përdorur, kërkon një interpretim tjetër.

2. Për qëllim të kësaj Direktive,

“PPP komunale” nënkupton çdo marrëveshje kontraktuese të partneriteti publiko-privat të zhvilluar dhe për t’u lidhur nga një komunë, për ofrimin e shërbimeve publike komunale ose infrastrukturë publike komunale në kuadër të fushës së tyre të përgjegjësisë siç përcaktohet me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, siç mund të amendamentohet kohë pas kohe;

“Direktiva Nr. 1/2011” nënkupton Direktivën Nr. 1/2011 të KDNM-PPP mbi procedurat për shqyrtimin dhe aprovimin e projekteve PPP.

## Neni 3: Rishikimi dhe miratimi i projekteve komunale PPP

Projektet komunale PPP do të shqyrtohen dhe miratohen nga KDNM-PPP, me mbështetjen e Njesisë PPP, me një procedurë të përshpejtuar dhe të thjeshtuar, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Direktivën Nr. 1/2011, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Direktivë.

## Neni 4: Afatet kohore për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve komunale PPP

1. Njësia PPP dhe KDNM-PPP do të ketë 30 ditë kalendarike nga dita e dorëzimit të projekt-propozimit PPP, në përputhje me Direktivën Nr. 1/2011, Neni 4, për ta shqyrtuar dhe miratuar një projekt komunal PPP.

2. Në rast se KDNM-PPP nuk ka marrë ndonjë vendim ose ndryshe hesht për projektin komunal PPP të dorëzuar për shqyrtim dhe miratim, projekti i tillë do të konsiderohet i miratuar pas skadimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni.

## Neni 5: Kriteret e shqyrtimit dhe miratimit

1. Njësia PPP dhe KDNM-PPP do ta shqyrtojë një projekt komunal PPP sipas kriterëve të mëposhtme:

- a. komuna posedon kompetenca ligjore për të ofruar shërbimin publik apo infrastrukturën e propozuar;
- b. komuna siguron një shpërndarje adekuate të rreziqeve ndërmjet sektorit privat dhe sektorit publik;
- c. komuna siguron financim adekuat gjatë gjithë ciklit të kohëzgjatjes së projektit për ta përmbushur ndonjë detyrim eventual financiar në lidhje me projektin;
- d. komuna i është përmbajtur, deri në masën e aplikueshme, të gjitha standardeve dhe direktivave të miratuara nga KDNM-PPP ose Njësia PPP.

2. KDNM-PPP do ta refuzojë një projekt komunal PPP vetëm nëse është e qartë dhe evidente se projekti nuk plotëson një ose më shumë kriteret e përcaktuara në këtë nen.

---

## **Neni 6: Miratimi i dhënies së kontratës**

1. Në bazë të Nenit 15 të Direktivës Nr. 1/2011, afati për shqyrtimin e një draft- marrëveshje PPP për zbatimin e një projekti komunal PPP nga KDNM-PPP do të jetë 5 ditë nga paraqitja e draftit për shqyrtim.
2. Në rast se KDNM-PPP nuk ka marrë ndonjë vendim ose hesht mbi projekt-marrëveshjen PPP të dorëzuar për shqyrtim, drafti i tillë do të konsiderohet i miratuar pas skadimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni.

## **Neni 7: Studimi i para-fizibilitetit**

Neni 3 i Direktivës Nr. 1/2011 nuk do të zbatohet për projektet komunale PPP

## **Neni 8: Zgjatja e afateve**

Me rekomandimin me shkrim dhe me arsyetim të Njesisë PPP, dhe pasi komunës t'i jetë dhënë mundësia t'i paraqesë pikëpamjet e veta dhe komentet, KDNM-PPP mund të zgjasë me shkrim çdo afat të përcaktuar në këtë Direktivë për një periudhë kohore që nuk kalon 15 ditë kalendarike, nëse kjo kërkohet për shkak të ndërlikueshmërisë së një projekt-propozimi apo ndonjë rrethane tjetër bindëse.

## **Neni 9: Hyrja në fuqi**

Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi ditën e miratimit të tij nga ana e KDNM-PPP dhe nënshkrimin të tij nga Kryesuesi i KDNM-PPP.

